



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr. 09/2017
Prishtinë, më 15.12.2017, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Dardan Molliqaj, Qëndron Kastrati, Memli Krasniqi dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

Të ftuar: Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit për Energji, Gani Jashari, anëtarë i Bordit të KOSTT-it.

Pjesëmarrës të tjerë: Barbora Poyner – Sekretariati i Komunitetit për Energji, Visar Shala, Nebih Haziri, Nebih Zariqi, Kadri Kadriu dhe Afrim Prekazi – KOSTT, Etleva Malushaj – GPP/LVV, Dardan Abazi dhe Amir Kozmaqi – INDEP, Agnesa Haxhiu – KDI, Anita Avdyli dhe Qëndresa Kastrat, praktikante.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Adresimi para Komisionit i Drejtorit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë z. Janez Kopaç, në lidhje me gjendjen aktuale të përputhshmërisë me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, nga ana e Kosovës;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT-it sh.a, për vitin 2016;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje

2. Adresimi para Komisionit i Drejtorit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë z. Janez Kopaç, në lidhje me gjendjen aktuale të përputhshmërisë me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, nga ana e Kosovës

Janez Kopaç, Drejtor i Sekretariatit të Komunitetit për Energji, pasi mori fjalën nga kryetarja e Komisionit, theksoi se ky takim është në kuadër të takimeve të rregullta që zhvillohen mes nesh. Ai tha se dje është zhvilluar takimi i parë i Këshillave Ministrorë në Kosovë që prej themelimit të organizatës, para 12 vitesh, me qëllim të integritit të vendeve të Ballkanit në fushën e energjisë. Ky komunitet ka përfshirë në vete vetëm energjinë, por me kohë në *aquis* të Komunitetit për Energji janë shtuar edhe gazi, nafta, energjia e ripërtëritëse etj. Kopaç, duke folur për sektorin e energjisë elektrike, theksoi problemin e bllokimit nga ana e Serbisë që po i bëhet Kosovës dhe si pasojë e këtij bllokimi KOSTT-i nuk po mundet të jetë anëtar me të drejta të plota në ENTSO-E. Duhet të bëni më shumë për energjinë e ripërtëritshme. Sa i përket çështjes për rezervat shtetërore të naftës, çdo shtet anëtar duhet të sigurojë rezerva të naftës për nëntëdhjetë (90) ditë, e kuptoj që kjo është mjaftë e kushtueshme për ju, por Kosova ende nuk e ka filluar një proces të tillë, kur kemi parasysh se shtetet tjera si Serbia, Maqedonia, Mali i Zi e kanë përfunduar këtë proces. Direktiva statistikore, Kosova ka të arritura në këtë direktivë por kërkon ende rritje të cilësisë së statistikave.

Mimoza Kusari-Lila, pyeti z. Kopaç, pse Kosova ka vonesa në përmbushje të energjisë së ripërtëritshme, sa do të ndikonte funksionalizimi i një ngrohtoreje me 100% biomasë, pasi ju e dini që si kryetare e Gjakovës kam qenë e angazhuar në një projekt për ngrohtore të tillë. Dhe, si e shihni ndërtimin e termocentralit të ri me 500 megavat me bazë thëngjillin?

Janez Kopaç: Gjakova mundet të jetë model se si gjërat mund të behën në sektorin e energjisë. Projekti i ngrohtores me 100% biomasë është projekt për të cilin kam vetëm fjalë të mira. Sa i përket burimeve të ripërtëritshme, ju nuk keni shumë hapësirë sepse ju nuk keni lumenj të mëdhenj, nuk keni pyje të mëdha, nuk keni aq shumë diell sikur shtetet tjera, por keni hapësirë ku mund të shfrytëzoni energjinë me erë, dhe kjo mund të shfrytëzohet shumë mirë, kjo formë e energjisë në 20 vitet e ardhshme do të jetë shumë funksionale, aty këtu edhe me gaz, por jo me thëngjill dhe me termocentrale.

Duda Balje: tha se Kosova kur ka vendosur të prodhojë deri në 30% të energjisë përmes burimeve të veta me hidrocentrale kemi shkatërruar shumë lumenj, a mund t'na tregoni se cilat janë përfitimet e cilat janë humbjet nga hidrocentralet dhe nga energjia e erës?

Janez Kopaç, para çdo investimi të analizojmë dhe përshtatim mirë ndikimet mjedisore dhe të vendosim atë që është në të mirë të mjedisit dhe natyrës. Kosova duhet të ketë prodhim të përzier të energjisë. Shqipëria prodhon energji kryesisht nga hidrocentralet, kurse Kosova nga termocentralet dhe kjo dëshmon me së miri për nevojën e bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushën e energjisë për prodhim të përzier të energjisë.

Hykmete Bajrami, foli për sfidën e Kosovës në krijimin e rezervave të obligueshme të naftës, kjo ka një kosto shumë të lartë për vendin tonë, a mund të na tregoni se cilat janë shtetet që kanë përparuar në këtë drejtim? Ne kemi bërë përpjekje që këto rezerva ti arrijmë përmes operatorëve privatë, ku do ti obligonim për të krijuar rezervat të mëdha e që edhe kontrollimi i cilësisë do të ishte me i lehtë, por kemi hasur në kundërshtime në këtë drejtim.

Dardan Sejdiu, po ashtu, kërkoi të dijë se a duhet të këtë një shtet fizikisht rezerva të naftës për 90 ditë.

Janez Kopaç, tha se ndër shtetet të cilat qëndrojnë mirë në këtë aspekt janë Serbia dhe Sllovenia. Po, një shtet duhet të këtë rezerva të naftës në rast të krizës apo ndonjë fatkeqësie natyrore. Ju keni ekspertin shqiptar në Komunitetin e Energjisë, z.Adrian Jasini, të cilin mund ta shfrytëzoni për nevojat tuaja si shtet.

Kryetarja, potencoi problemin e mungesës së anëtarëve të Bordit të ZRRE-së dhe premtoi se ky Bord në momentin që Qeveria sjell propozimet do të kompletohet dhe do ta kalojmë këtë problem, po ashtu, kërkoi që të behët me shumë presion mbi Serbinë për zbatim të marrëveshjes së energjisë, në mënyrë që KOSTT-i të jetë anëtar e plotë në ENTSO-E.

Janez Kopaç, tha se është një problem i madh, ne si Sekretariat kemi bërë shumë përpjekje por deri me tani nuk ka funksionuar, sepse Serbia po e pengon më të gjitha format KOSTT-in që të jetë anëtar i ENTSO-E.

Pas debatit Komisioni, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Komisioni do të bashkëpunojë ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe si vend do ti kryej obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Gjithashtu, do të merr pjesë në Plenumin që organizohet në kuadër të këtij Komuniteti.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a, për vitin 2016;

Kryetarja, theksoi se pasi që është hera e parë që KOSTT-i i raporton Kuvendit respektivisht Komisionit, kjo erdhi si rezultat i një kërkesë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ku Kosova është anëtare e këtij Komuniteti dhe ka dal si kërkesë që të ndahen KEK-u dhe KOSTT-i dhe te mos zgjidhen nga i njëjti institucion, në këtë rast nga Qeveria sepse kanë konsideruar se është konflikt interesi. Dhe, ne kemi shfrytëzuar rastin në atë kohe kemi bërë plotësim ndryshimin e Ligjit për Energjinë Elektrike, ku me dispozitë të posaçme është vendos që KOSTT-i ti raportojë Kuvendit të Kosovës, mirëpo, me status të mbetet si ndërmarrje publike.

Gani Jashari, anëtarë i Bordit të KOSTT-it: Ju sigurisht jeni të informuar se përbërja e bordit

tani për tani është e cunguar, pasi tre nga anëtarët e bordit janë shkarkuar nga Kryeministri para pak kohe. Raporti vjetor i KOSTT-it për vitin 2016 është i bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Ky raport paraqet rezultatet kryesore të arritura gjatë vitit 2016. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme ne nuk kemi mundur të arrijmë anëtarësimin në ENTSO- E, për shkak të pengesës së Serbisë, si rezultat i këtyre pengesave linja 400 kilovolt Kosovë-Shqipëri, edhe pse është përfunduar me kohë, nuk po mund të shfrytëzohet. Gjatë vitit 2016, në rrjetin transmetues të Kosovës, janë transmetuar 8200 Gigavat orë energji elektrike apo 3.8% më pak se në vitin 2015, për shkak të transitit të energjisë elektrike, e cila ka qenë nëpër rrjetin e transmisionit të Kosovës. Rrjetit të energjisë së Kosovës ju shtua një linjë e re prej 91 km, e nivelit 400 Kilovat e cila po të shprehet në linjën e përgjithshme të energjisë së Kosovës është afër 48% në rritje, këtu i referohemi linjës ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri, e cila u inaugurua në qershor të vitit 2016 në Tiranë, por për shkak të mosimplementimit të marrëveshjes për kyçje në ENTSO-E dhe arsyet e njohura, kjo linjë ende nuk është komercializuar nga KOSTT-i.

Sala Berisha-Shala: Të nderuar deputetë, me kohë keni marr këtë raport dhe besoj që keni pas kohë për ta shqyrtuar në detaje, po ashtu, z. Jashari, ne jemi të informuar me shkarkimin e një pjese të anëtarëve të Bordit nga ana Kryeministrit. Si Komision kemi kërkuar nga Zyra Ligjore e Kuvendit, të na interpretojë anën ligjore të këtij shkarkimi sepse është dilemë e madhe se a ka pasur të drejtë Kryeministri ta shkarkojë një pjesë të bordit të atij institucioni, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, pasi kërkuam opinionin e Zyrës Ligjore të Kuvendit, ajo nuk dëshoi të interpretojë vendimet e Qeverisë.

Dardan Sejdiu: Vendimi i Kryeministrit për shkarkim të një pjese të anëtarëve të Bordit të KOSTT-it është i kundërligjshëm. Ky vendim përbën tejkalim të kompetencave të tij dhe ndërhyrje të Qeverisë në një ndërmarrje publike, e cila tashmë nuk i përgjigjet Qeverisë, por Kuvendit. Andaj, kërkoj nga ju kolegë deputetë që t'ia dërgojmë një shkresë Kryeministrit, që të na sqarojë ligjshmërinë e këtij vendimi. Nëse një propozim i tillë nuk përkrahet nga ju, unë ju informoj se Grupi Parlamentar i LVV-së, do ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese këtë vendim, pasi që kjo është ndërhyrje në kompetencat e institucionit më të lartë në vend, pra Kuvendit të Kosovës. Kjo ndërhyrje e Kryeministrit e bën të pakuptimtë raportimin e këtij institucioni sot para Kuvendit, kur në fakt punën e këtij institucioni po e vlerëson Kryeministri. Sa i përket raportit kam disa vërejtje. Është bërë më shumë se një vit nga inaugurimi i linjës së interkonjeksionit Kosovë-Shqipëri, humbjet vjetore të përbashkëta të mosfunktionalizimit të kësaj linje sipas një përlllogaritje që kemi bërë janë rreth 15 milionë euro në vit, pra ne paguajmë kredi pa shfrytëzuar të mirat për të cilat kemi marr kredi. Në raport ceket që përkundër angazhimit tuaj, pengesa nga ana e Serbisë ka bërë që linja 400 kilovoltëshe të mos funksionalizohet. Pyetja ime e parë, edhe se a keni një afat të fundit të paramenduar se kur duhet të fillojë linja e interkonjeksionit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë? Çfarë veprime konkrete planifikoni të merrni për të futur në veprim internkonjeksionin? Pyetja tjetër ka të bëjë me marrjen e masave reciproke në mbrojtjen e interesave ekonomike të Kosovës, është e rëndësishme të kuptoj se çka ka ndodh pas datës 30 mars, kur është nënshkruar deklarata në mes të ministrit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë, për bashkëpunim në krijimin dhe operimin e bursës Shqiptare të energjisë, sipas raportit, te disa pjesë në këtë drejtim keni treguar angazhim, por cilat janë masat konkrete, pra a mund të dimë se deri ku kemi përparuar në krijim të bursës, meqë ka kaluar me shumë se një vit nga nënshkrimi i deklaratës?

Hykmete Bajrami, pohoi që përkrah iniciativën e deputetit Dardan Sejdiu për ti dërguar letër Kryeministrit lidhur me shkarkimin e një pjesë të Bordit. Kuvendi i Kosovës si institucion ka hendek sa i përket raportimeve të institucioneve tjera, pasi që edhe po te jetë një raport jo në nivel, ne nuk kemi masa ndëshkimore. Kërkoj sqarim lidhur me shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv në gusht të këtij viti, sepse ne jemi informuar me një shkresë prej aksionarit dhe përfaqësuesit të Kuvendit z. Musa Leka, e jo nga ju.

Mimoza Kusari – Lila, e përkrahu iniciativën e deputetit Dardan Sejdiu për ti dërguar letër Kryeministrit, në lidhje me shkarkimin e një pjesë të Bordit dhe thas se Ligji për Ndërmarrjet Publike parasheh pjesëmarrjen gjinore në 50% në Bord, kurse ju sot siç duket nuk e keni asnjë anëtare grua këtu. Te raporti i KOSST-it me intereson rritja e numrit të punëtoreve. E keni rritur numrin e punëtoreve për 11, pse ka ardhur deri te kjo rritje dhe dua të dijë më shumë për mosinkuadrimin e KOSTT-it në ENSTO-E.

Duda Balje, tha se në KOSST kemi pasur përfaqësuesin e komunitetit boshnjak, por është shkarkuar nga Kryeministri dhe për këtë kërkojë informacione shtesë. Është në interesin tonë ta dimë se energjia e cila është paguar për pjesën veriore, e te cilën nuk e kemi shpenzuar si do të kompensohet?

Bilall Sherifi, tha se sa i përket shkresës për revokim të vendimit të Kryeministrit, unë nuk e përkrah sepse një bord i emëruar në baze të një ligji mund edhe të shkarkohet nga baza ligjore e të njëjtit ligj. E përkrah këtë iniciativë por në formë të një shkrese sqaruese.

Kryetarja, kërkoj nga deputetet që të fokusohen në raportin e KOSTT-it për vitin 2016, po ashtu theksoi se KOSST-i në raportin e tyre është dashur të cek se a ka nevojë për ndryshime ligjore sa i përket veprimtarisë se tyre, kjo është e cekur edhe në analizën e bërë nga INDEP-i.

Kadri Kadriu, u.d. kryeshef i KOSTT-it,tha se ne vitin 2006 kur është themeluar KOSTT-i në atë kohë kemi pasur kapacitete transmetuese 800 Megavat dhe kërkesa për energji elektrike ka qene mbi 1000 Megavat. Atë kohë edhe po te kishim energji elektrike të mjaftueshme për shkak të fyteve te ngushta transmetuese, ne nuk kemi mundur të realizojmë transmetim të energjisë, ndërsa sot kemi kapacitete transmetuese 1700 Megavat, që i bie se kemi pasur zhvillim shumë substancial në këtë drejtim me përkrahje edhe të institucioneve relevante. Ne kemi arritur që për dhjetë vite të kursejmë 25- 27 milionë euro vetëm në humbje të energjisë elektrike. Sa i përket tregut Kosovë – Shqipëri, duhet cekur se iniciativa për një treg të tillë ka qenë prej KOSTT-it dhe është e hershme në bazë të së cilës është sot linja e transmetimit mes dy vendeve, kjo linje ka për qëllim dy komponentë dhe atë ta bëjë shkëmbimin e energjisë mes dy vendeve që sot ende është në nivelin minimal, dhe të krijojë një treg të përbashkët nga i cili benefitet ekonomike do të jenë mjaftë të larta për të dyja vendet. Sa i përket asaj se çka është bërë nga ana jonë për hapje të tregut, në vitin 2016, Ligji për Energjinë është aprovuar dhe ka dhënë afate që brenda 9 (nëntë) muajve të fillojë operimin në tregun e hapur të ZRRE-së, menjëherë e ka hapur tregun dhe kjo natyrisht ka qenë një faze e rëndësishme e zhvillimit të sektorit, tregu me shumice faktikisht është treg i lirë. Sa i përket numrit të punëtorëve, ne kemi një skemë organizative dhe një dokument që është sistematizimi dhe qe është i aprovuar nga Bordi i drejtoreshave. Sipas këtij dokumenti, ne duhet ti kemi 381 punëtorë, kurse tash i kemi 360 dhe ne si KOSST nuk kemi lejuar mbipunësime. Ne jemi te gatshëm t'ju presim në vizitë dhe të

shihni nga afër funksionimin e KOSTT-it. Lidhur me pyetjen për furnizimin me energji në veri të Kosovës, është e vërtetë që KOSTT-i në këtë vit ka qenë furnizues i veriut me energji me vendim të ZRRE-së, edhe pse ne nuk jemi furnizues me rregulla, por ZRRE-ja ka të drejtë në bazë të ligjit që të jep përgjegjësi shtesë, por paralelisht duhet të kompensohet nëse jep detyra shtese dhe kompensimin, deri në fund të muajit nëntor, ne e kemi furnizuar veriun me energji dhe të hyrat i kemi pasur prej konsumatorëve qysh janë parapare me tarifa. Ne fund të nëntorit është marr vendimi i Shkalles së Dytë të Gjykatës, i cili thotë se duhet të hiqen humbjet teknike nga fatura, ZRRE-ja e ka leshu një udhëzim me të cilin thotë se 44% e të hyrave të KOSTT-it duhet zvogëluar, tani ne kemi 44% të hyrave, që ka impakt rreth 4 milion euro në vit me pak, dhe kjo na shkakton një dëm financiar si kompani. Nëse vazhdohet deri në prill, e energjia shtrenjtohet kryesisht për shkak të sezonit të dimrit, atëherë na shkaktohen humbje, prandaj, uhet të bëhet një zgjidhje sepse ne kështu nuk mund të operojmë.

Mimoza Kusari – Lila, tha se ne si Komision jemi që ti mbrojmë interesat tuaja, qëllimi nuk është të vijmë të inspektojmë numrin e punëtoreve, por t’ju mbrojmë nga ndikimet politike e që nuk janë të rralla rastet e tilla në ndërmarrjet publike, besoj po e kuptoni drejt qëllimin tonë.

Dardan Sejdiu, pyeti se sa është e rëndësishme Kosova në tregun rajonal të furnizimit me energji? Sa kemi kapacitete që të mund të kushtëzojmë ne këtë treg?

Kadri Kadriu, u.d. kryeshef i KOSTT-it, tha se po kemi një rol shumë të rëndësishëm në kontributin e tregut rajonal por edhe përfitojmë shumë nga ky treg.

Arsim Prekazi, anëtarë i Bordit të KOSTT-it, tha se sa i përket shkarkimit të kryeshefit ekzekutiv të KOSTT-it është jashtë raportit sepse në raport përfshihen vetëm punët e vitit 2016, dhe kjo ngjarje i takon vitit 2017. Ne mund t’ua dërgojmë një përgjigje me shkrim për rastin në fjalë. Është edhe duke u udhëhequr një proces gjyqësor ndaj këtij rasti dhe nuk dua të ndërhyjë në çështje të tilla.

Hykmete Bajrami, tha se pavarësisht që kjo çështje i takon këtij viti, e jo vitit 2016, për çka është Bordi duke raportuar, ky Bord duhet të jep përgjigje për pyetjet dhe çështjet që ngritën nga deputetët.

Kryetarja, kërkoi nga Bordi që në një afat sa më shkurt të sillt një raport me përgjigje në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga ana e deputetëve.

Komisioni, me 5(pesë) vota Për dhe 1 (një) Kundër, nxori këtë:

Përfundim

I. Të miratohet Raporti vjetor për vitin 2016, i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut – KOSTT sh.a, me rekomandimet si vijon:

- *Qeveria dhe KOSTT-i të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore që sa më shpejt të arrihet anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E;*

- *KOSTT-i të ndërmarrë veprimet e nevojshme për tejkalimin e situatës së krijuar me vendimin e Gjykatës lidhur vendimin e ZRRE-së “V-399-2012“;*
- *KOSTT-i në raportet e ardhshme vjetore, të përshkruaj më hollësisht zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese dhe nevojën eventuale për ndryshime, të përshkruaj më hollësisht strukturën e personelit, si dhe raporti të ketë qasje më analitike të aktiviteteve të KOSTT-it.*

II. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputetja Sala Berisha – Shala, kryetare.

III. Komisioni ti dërgojë letër Kryeministrit, ku do të kërkojë sqarim lidhur më shkarkimin e një pjesë të Bordit të KOSTT-it.

4. Të ndryshme.

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45.

**E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit**

Kryetare e Komisionit,

Sala Berisha – Shala
